

**STATUTI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“DUEMARI” SHPK**

Bazuar në ligjin 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, dhe të akteve të tjera ligjore dhe nënligjore, që rregullojnë fushën e regjistrimit, licencimit dhe funksionimit të subjekteve tregtare në Republikën e Shqipërisë, në Vlore, sot, më datë 01 MARS 2022 ne Ortaket , shpallim statutin e kësaj Shoqërie tregtare si më poshtë vijon:

**FORMIMI**  
**Neni 1**  
**Emri i shoqërisë**

Formohet shoqëria tregtare me emërtimin **“DUEMARI” sh.p.k.**, (këtu e në vijim referuar si **“shoqëria”**), shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me një ortak themelues.

**Neni 2**  
**Selia e shoqërisë**

1. Vendqëndrimi i shoqërisë tregtare **“DUEMARI” sh.p.k.**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar do të jetë në: me Lagjia Uji i Ftohte,Rruga Murat Terbaci,Pallati Ansi,Kulla 1,Kati i Pare nr.1 .Vlore Veprimtaria e saj private ushtrohet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.
2. Adresa e postës elektronike për komunikimin elektronik [duemari@gmail.com](mailto:duemari@gmail.com) tel:0695615698
3. Asambleja e Përgjithshme mund të vendos për transferimin e selisë së shoqërisë në një adresë tjetër, si dhe të vendos në lidhje me ndryshimin e të dhënave adresore dhe/ose mbylljen/hapjen e vendqëndrimeve të tjera, degëve, zyrave të përfaqësimit, filialeve, agjenci, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe në çdo shtet tjetër të huaj, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë me miratim të asamblesë së përgjithshme dhe në përputhje me ligjet e vendit apo shtetit përkatës ku ato do të hapen.
4. Shoqëria me vendimin e asamblesë së përgjithshme të saj, mund të investojë apo të marrë pjesë në kapitale të shoqërive të tjera me karakter tregtar apo investues, në shoqëri të tjera vendase apo të huaja, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
5. Shoqëria me vendimin e asamblesë së përgjithshme të saj, mund të kryejë operacione financiare duke u përfshirë në tregjet financiare apo tregjet e kapitaleve, të mbyllura apo të hapura, kombëtare apo ndërkombëtare.
6. Asambleja e Përgjithshme mund të vendos për transferimin e selisë së shoqërisë në një adresë tjetër, si dhe të vendos në lidhje me ndryshimin e të dhënave adresore dhe/ose mbylljen/hapjen e vendqëndrimeve të tjera, degëve, zyrave të përfaqësimit, filialeve, agjenci, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe në çdo shtet tjetër të huaj, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë me miratim të asamblesë së përgjithshme dhe në përputhje me ligjet e vendit apo shtetit përkatës ku ato do të hapen.
7. Shoqëria me vendimin e asamblesë së përgjithshme të saj, mund të investojë apo të marrë pjesë në kapitale të shoqërive të tjera me karakter tregtar apo investues, në shoqëri të tjera vendase apo të huaja, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
8. Shoqëria me vendimin e asamblesë së përgjithshme të saj, mund të kryejë operacione financiare duke u përfshirë në tregjet financiare apo tregjet e kapitaleve, të mbyllura apo të hapura, kombëtare apo ndërkombëtare.
9. Shoqëria me vendimin e asamblesë së përgjithshme të saj, mund të kryejë operacione financiare dhe transaksione financiare, me shoqëri të tjera brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të cilat janë në pronësi të ortakëve të saj, apo në të cilat ortakët e shoqërisë **“DUEMARI” sh.p.k** në Shqipëri, mund të jenë ortakë apo aksionerë edhe në këto shoqëri të tjera.
10. Shoqëria mund të shtojë numrin e ortakëve duke ndryshuar në këtë mënyrë numrin e ortakëve dhe pjesëmarrjen e tyre në kuotat e shoqërisë. Për këtë arsye për të parashikuar mënyrën e funksionimit në rastet e shtimit të ortakëve në këtë statut janë përfshirë disa klauzola të përgjithshme që garantojnë funksionimin normal në periudha tranzitore. Në rast të shtimit të numrit të ortakëve dhe shndërrimit të

shoqërisë nga shoqëri me një ortak në shoqëri me shumë ortakë, do të depozitohen ndryshimet në QKB dhe do të specifikohen klauzolat e statutit, në përputhje me statutet e reja të krijuara.

11. Brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga shtimi i numrit të ortakëve, asambleja e ortakëve në mbledhje të jashtëzakonshme të saj do të vendosë për ndryshime eventuale të organeve, administratorit dhe statutit të shoqërisë.  
Asambleja e Përgjithshme mund të vendos për transferimin e selisë së shoqërisë në një adresë tjetër, si dhe të vendos në lidhje me ndryshimin e të dhënave adresore dhe/ose mbylljen/hapjen e vendqëndrimeve të tjera, degëve, zyrave të përfaqësimit, filialeve, agjenci, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe në çdo shtet tjetër të huaj, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë me miratim të asamblesë së përgjithshme dhe në përputhje me ligjet e vendit apo shtetit përkatës ku ato do të hapen.
12. Shoqëria me vendimin e asamblesë së përgjithshme të saj, mund të investojë apo të marrë pjesë në kapitale të shoqërive të tjera me karakter tregtar apo investues, në shoqëri të tjera vendase apo të huaja, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
13. Shoqëria me vendimin e asamblesë së përgjithshme të saj, mund të kryejë operacione financiare duke u përfshirë në tregjet financiare apo tregjet e kapitaleve, të mbyllura apo të hapura, kombëtare apo ndërkombëtare.
14. Shoqëria me vendimin e asamblesë së përgjithshme të saj, mund të kryejë operacione financiare dhe transaksione financiare, me shoqëri të tjera brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të cilat janë në pronësi të ortakëve të saj, apo në të cilat ortakët e shoqërisë **"DUEMARI" sh.p.k** në Shqipëri, mund të jenë ortakë apo aksionerë edhe në këto shoqëri të tjera.
15. Shoqëria mund të shtojë numrin e ortakëve duke ndryshuar në këtë mënyrë numrin e ortakëve dhe pjesëmarrjen e tyre në kuotat e shoqërisë. Për këtë arsye për të parashikuar mënyrën e funksionimit në rastet e shtimit të ortakëve në këtë statut janë përfshirë disa klauzola të përgjithshme që garantojnë funksionimin normal në periudha tranzitore. Në rast të shtimit të numrit të ortakëve dhe shndërrimit të shoqërisë nga shoqëri me një ortak në shoqëri me shumë ortakë, do të depozitohen ndryshimet në QKB dhe do të specifikohen klauzolat e statutit, në përputhje me statutet e reja të krijuara.
16. Brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga shtimi i numrit të ortakëve, asambleja e ortakëve në mbledhje të jashtëzakonshme të saj do të vendosë për ndryshime eventuale të organeve, administratorit dhe statutit të shoqërisë.
17. Shoqëria në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme të saj merr vendime edhe kur ortaku i shoqërisë në minorance mund të mos jete dakort apo të mos marrë pjesë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme.

### **Neni 3**

#### **Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e veprimtarisë ekonomike të shoqërisë tregtare **"DUEMARI" sh.p.k.** është e për një kohë të pacaktuar

### **OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

#### **Neni 4**

#### **Objekti i aktivitetit**

Shoqëria do të ushtroj objektin e veprimtarisë në fushën e: Bar-Restorant-Sherbime dhe organizim eventesh.

Asambleja e Përgjithshme ka të drejtë të përcaktojë modalitetet për zgjerimin apo zvogëlimin e fushës së aktivitetit të kryer.

Shoqëria tregtare mund të ndryshojë emërtimin, vendqëndrimin dhe objektin e veprimtarisë së saj sipas vendimeve që do të marrë Asambleja e Përgjithshme.

Shoqëria zbaton ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 *"Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"*, të ndryshuar, për ushtrimin e veprimtarisë të saj.

### **KAPITALI I SHOQËRISË**

## Neni 5 Kapitali i shoqërisë

5.1. Kapitali i shoqërisë është 100,000 leke, dhe është i ndarë në dy kuota. Aksionet janë të pandashme.

5.2. Kapitali i shoqërisë zotërohet nga aksionerët si më poshtë:

- a) Ortaku **Zaho Tozaj** zotëron një kuota me vlerë të përgjithshme 75,000, që përbën 75% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- b) Ortaku **Fabio Likaj** zotëron një kuota me vlerë të përgjithshme 25,000, që përbën 25% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

## Neni

6

### Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

1. Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet ose zvogëlohet në çdo moment me vendim të organeve drejtuese të shoqërisë, në përputhje me parashikimet e Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar.
2. Në çdo rast kapitali i regjistruar nuk mund të zvogëlohet nën kufirin minimal të parashikuar nga ligji.  
Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur detyrimin e tij në kapitalin themelor. Pjesët e kapitalit themelor janë lirish të transferueshme prej trashëgimtarëve të çdo ortaku në rast vdekjeje.

## DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

### Neni 7

#### Asambleja e përgjithshme

1. Organi më i lartë i shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme, ajo përbëhet prej ortakut të shoqërisë. Asambleja është organi sovran i shoqërisë duke u mbështetur në të drejtën e tyre të pronësisë private mbi mjetet e investuara në shoqëri.
2. Asambleja zhvillon mbledhje të zakonshme dhe të jashtëzakonshme. Ajo thirret jo më pak se dy herë në vit. Në mbledhje të jashtëzakonshme shqyrtohen dhe vendosen probleme që kanë të bëjnë me krijimin, bashkimin, ndarjen, shpërndarjen, ndryshimin e statutit e probleme të tjera të rëndësishme për të cilat kërkohet miratimi i përbashkët nga ortakët themelues.
3. Asambleja e Përgjithshme përcakton dhe miraton të drejtat dhe detyrat e organeve të saj. Të zgjedhurit dhe të emëruarit nga Asambleja veprojnë në përputhje me dispozitat e këtij statuti, aktit të themelimit si dhe ligjeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Vendimet që merr Asambleja sipas këtij statuti dhe legjisllacionit në fuqi janë të detyrueshme për çdo ortak. Secili ortak ka të drejtë vote sipas përqindjes në kuota të kapitalit themelues të shoqërisë.
4. Secili ortak që ka të drejtën e pjesëmarrjes së Asamble, mund të përfaqësohet në të edhe nga një person tjetër i autorizuar e shkrim nga ortaku i shoqërisë.
5. Të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm, për sa kohë shoqëria ka vetëm një ortak.  
Vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:  
a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve; c) investime; ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
6. Çdo vendim i ortakeve që është i paregjistruar në regjistrin e vendimeve do të konsiderohet absolutisht i pavlefshëm.

7. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.
8. Nëse shoqërisë i shtohen ortakë të tjetër përveç themeluesit, që është në cilësinë e ortakut të vetëm, atëherë asambleja e përgjithshme do të thirret, mbledhet dhe vendosë në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar.

## Neni 8

### Administrimi i shoqërisë

1. Kjo shoqëri ka statusin e personit juridik shqiptar dhe i nënshtrohet legjislacionit përkatës shqiptar.
2. Shoqëria do të administrohet nga administratori Zaho Tozaj i zgjedhur nga ortakët për një periudhë maksimale prej 5 (pesë) vjetësh. Administratori mund të rizgjidhet ose shkarkohet nga ortaku i vetëm.
3. Me themelimin e këtij akti, administrator i shoqërisë caktohet për një periudhë 5 (pesë) vjeçare).
4. Në këtë shoqëri mund të aderojnë ortakë të tjerë të rinj në kushtet që do të përcaktohen në akt marrëveshjen e bërë në rastin e pranimin të tyre.
5. Po ashtu ortakët kanë të drejtën të ndryshojnë apo shtojnë objektin e veprimtarisë së shoqërisë, sipas interesave të veta ekonomike dhe financiare.
6. Administratori gëzon të drejta të plota në lidhje me administrimin e shoqërisë dhe mund të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm. Ai mban përgjegjësi për veprimet e kryera gjatë administrimit të shoqërisë dhe mund të delegojë të tretë për të kryer veprime dhe akte të caktuara, në emër dhe për llogari të shoqërisë.
7. Administratori i vetëm vepron në respektim të politikave tregtare të përcaktuara nga asambleja e përgjithshme. Ai është përgjegjës për veprimet e kryera gjatë administrimit të shoqërisë, si dhe duhet të veprojë në çdo kohë vetëm në interesin më të mirë të shoqërisë.
8. Shpërblimi i administratorit përcaktohet nga Asambleja e Përgjithshme
9. Çështjet e punësimit dhe marrëdhënies së punës së administratorit të vetëm rregullohet nga legjislacionin në fuqi për marrëdhëniet e punës, si dhe për sigurimet shoqërore e shëndetësore.

## Neni 9

### Krijimi i shoqërisë

1. Shoqëria tregtare "sh.p.k" deklarohet se është krijuar dhe operon në zbatim të plotë të normave të legjislacionit shqiptar, të statutit, aktit të themelimit. Shoqëria fiton zotësinë për të vepruar me regjistrimin e saj si person juridik në Regjistrin Tregtar të QKB-së (Qendrës Kombëtare të Regjistrimit të Biznesit).
2. Administrator i Shoqërisë do të përcaktohet me vendimin e asamblesë së përgjithshme të ortakëve. Afati i emërimit në detyrë të administratorit është 5 vjet me të drejtë riemërimi.

## Neni 10

### Vula e shoqërisë dhe llogaritë bankare

1. Shoqëria ka vulën e saj, me mbishkrimin e emrit të shoqërisë "DUEMARI" sh.p.k.
2. Ajo do të hapë llogarinë e saj bankare në lekë e valuta të tjera në Bankat e nivelit të dytë në Republikën e Shqipërisë ose jashtë Republikës së Shqipërisë.

## Neni 11

### Përgjegjësitë e shoqërisë

1. Shoqëria tregtare "DUEMARI", sh.p.k, vepron në regjimin e pronës private dhe merr përsipër vetëm të drejta dhe detyrime kontraktuale dhe jo kontraktuale brenda kapitalit të saj.
2. Ortaku/ortakët e shoqërisë mbartin rrezikun për rezultatet e veprimtarisë së shoqërisë në nivelin e kapitalit themelor të shoqërisë duke mos u përgjigjur me pasuritë vetjake të realizuara në veprimtari të tjera ekonomike për detyrimet e kësaj shoqërie.

## Neni 12

### Emërimi i organeve ose personave të tretë

1. Sipas nevojave që paraqiten për zhvillimin e veprimtarisë ekonomike të shoqërisë, Asambleja emëron organe kontrolli si dhe punëson persona të tjerë të cilët qëndrojnë në detyrë deri sa të kërkohet nga Asambleja ose largohen me dëshirën e tyre.
2. Administratorit me përjashtim të rastit kur është ortak i vetëm dhe administrator, nuk i lejohet të kontraktojë në çfarëdo forme qoftë të marrë hua në shoqëri të tjera, të japë pëlqimin në emër të shoqërisë për paradhënie e të bëhet dorëzanës apo të garantojë në emër të saj ndaj të tretëve.

#### **Neni 13**

#### **Detyrat e Administratorit**

1. Administratori merret me drejtimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë pa kufizime.
2. Administratori ka për detyrë të njoftojë e të japë llogari në Asamblenë e Ortakëve me përjashtim të rastit kur është ortak i vetëm dhe administrator dhe si i tillë i mbart vetë këto cilësi.

### **MARRËDHËNIET E PUNËS**

#### **Neni 14**

#### **Kontrata e Punës**

Marrëdhëniet e punës në shoqëri rregullohen nëpërmjet kontratës së punës duke zbatuar legjislacionin shqiptar. Shoqëria merr përsipër që të respektojë rregullat në fuqi të punësimit, ndërsa të punësuarit janë të detyruar të pranojnë këtë statut dhe çdo akt që rregullon veprimtarinë e shoqërisë.

#### **Neni 15**

#### **Përgjegjësia e punonjësve**

1. Të punësuarit në shoqëri përgjigjen sipas ligjit dhe sipas statutit. Për mos zbatimet dhe dëmet që mund t'i shkaktojnë shoqërisë mbajnë përgjegjësi administrative, disiplinore e penale.
2. Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis të punësuarve dhe punëdhënësit kur nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim, secila palë ka të drejtë që t'i drejtohet organeve të drejtësisë.

#### **Neni 16**

#### **Marrëdhënia e të punësuarve me kapitalin e shoqërisë**

1. Punonjësit e emëruar apo të punësuar nuk marrin pjesë në ndarjen e fitimit që realizon shoqëria në veprimtarinë e saj ekonomike, ndërsa kontrata e punës nuk është e parashikuar ndryshe.
2. Të gjithë të punësuarit në shoqëri, janë të detyruar të ruajnë sekretin e punës në shoqëri. Kjo është e detyrueshme dhe pas largimit nga puna e tyre.

### **PËRFAQESIMI I ADMINISTRATORIT**

#### **Neni 17**

#### **Caktimi i avokatit**

1. Përfaqësimi i shoqërisë tregtare "DUEMARI" SH.P.K., i takon Administratorit aktual të emëruar prej të saj. Ai ka të drejtë që të përfaqësojë shoqërinë në organet gjyqësore, bankare të caktojë dhe emërojë avokatë ose përfaqësues të tjerë kur është e nevojshme.

#### **Neni 18**

#### **Kontrolli financiar**

1. Kontrolli financiar i shoqërisë kryhet nga auditues ligjor, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Shoqëria organizon kontrollin e brendshëm me ekspert kontabël të emëruar me ose pa afat. Ortaku i vetëm emëron një apo më shumë auditues ligjor në të gjitha ato raste kur emërimi vlerësohet i nevojshëm ose kërkohet nga ligji.
2. Ekspertët kontabël kontrollojnë dhe garantojnë që llogaritë vjetore të jenë të rregullta, të besueshme për rezultatin dhe gjendjen financiare. Ata kontrollojnë mbajtjen dhe evidentimin e veprimtarive financiare në përshtatje me ligjin dhe aktet e tjera për kontabilitetin. Ata janë përgjegjës ndaj shoqërisë

dhe ndaj të tretëve për pasojat që rrjedhin nga fajet apo paafësitë e tyre në kryerjen e detyrës.

**Neni 19**  
**Viti financiar**

Viti financiar i shoqërisë fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti, me përjashtim të vitit të parë të aktivitetit të shoqërisë, i cili fillon në datën e regjistrimit të shoqërisë dhe mbyllet në fund të këtij viti.

**BILANCI DHE TË ARDHURAT**  
**Neni 20**

**Viti financiar**

1. Viti financiar i shoqërisë fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti, me përjashtim të vitit të parë të aktivitetit të shoqërisë, i cili fillon në datën e regjistrimit të shoqërisë dhe mbyllet në fund të këtij viti.
2. Si rregull veprimet ekonomike të Shoqërisë mbyllet më 31 Dhjetor të çdo viti, përjashtim nga

ky rregull do të bëhet kur kërkon organi kompetent ligjor.

1. Veprimtaritë ekonomike dhe financiare të shoqërisë mbyllet më datë 31 Dhjetor të çdo viti. Administratori i shoqërisë nxjerr bilancin kontabël dhe raportin përkatës në përputhje me dispozitën ligjore dhe kontabilitetin.
2. Raporti i administrimit, inventaret, bilancet dhe llogaritë vjetore të hartuara i nënshtrohen pa përjashtim miratimit nga Asambleja e ortakëve (ortaku i vetëm) brenda afateve të caktuara.
3. Me miratimin e bilancit kontabël shoqëria vendos për fondet e nevojshme për zhvillimin, si p.sh fondi rezervë, akte të akumulimit, investimit, etj.

**Neni 21**  
**Bilanci vjetor dhe dividendi**

1. Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, raportet e organit të administrimit dhe të audituesit ligjor (nëse është emëruar) miratohen nga Asambleja e Përgjithshme
2. Dokumentet që kanë të bëjnë me vitin financiar miratohen nga Asambleja e Përgjithshme vetëm brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.
3. Asambleja e Përgjithshme vendos mbi shpërndarjen e dividendit në bazë të rezultatit financiar të shoqërisë, sipas parashikimit të legjislacionit në fuqi.
4. Të ardhurat neto pas veçimit të fondeve si më sipër dhe shlyerjes së detyrimeve fiskale i mbesin për përdorim ortakëve të shoqërisë të cilët i ndajnë midis tyre në përputhje me kuotat e secilit në formimin e kapitalit themelor të shoqërisë përcaktuar sipas parashikimeve të aktit të themelimit.
5. Çdo ortak ka të drejtën e transferimit jashtë vendit të pjesës së fitimit duke zbatuar dispozitat ligjore për këtë.
6. Asambleja e ortakëve mund të vendosë që të shpërndahen shumat e fondeve të rezervuara duke treguar shprehimisht llojin e rezervës ku janë marrë.

**Neni 22**  
**Ruajtja e dokumentacionit**

Në selinë e shoqërisë tregtare mbahet dokumentacioni i plotë i saj, mbahen protokollet e ndryshme, dokumentacioni i kontabilitetit ku mund të bëhet vetëkontroll ose për t'ia vënë në dispozicion çdo organi kontrolli ta ngarkuar me ligj. Dokumentet e shoqërisë duhet të njohet mirë nga ortakët.

## Prishja dhe likuidimi i shoqërisë

1. Shpërbërja e shoqërisë mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak si në rastin e falimentimit, privimi i të drejtës për të ushtruar profesionin e tregtarit, forca madhore, raste lufte dhe çdo formë tjetër që nuk varet nga dëshira e Asamblesë së ortakëve. Në rast të prishjes dhe likuidimit të shoqërisë, do të zbatohet dispozitat e Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar.
2. Në çdo rast Asambleja vendos mbi mënyrën e likuidimit të shoqërisë duke caktuar një ose më shumë likuidatorë.
3. Likuidatorët dhe administratorët janë përgjegjës për ruajtjen e pasurisë së shoqërisë derisa t'u dorëzohet personave përkatës fizik e juridikë duke i dhënë përparësi likuidimit të detyrimit të shoqërisë ndaj të tretëve.
4. Mbas likuidimit të të gjithë detyrimeve ndaj të tjerëve likuiduesi i ndan kapitalet e mbetura mes ortakut/ortave përpjesëtimisht me kuotat që ata zotërojnë në kapitalin themelor.
5. Mbase bëhet njoftimi i mbylljes së likuidimit dhe kryhen formalitetet e mbylljes. Shoqëria ç'regjistrohet nga regjistri i tregtarëve të QKB-së (Qendrës Kombëtare të Regjistrimit të Biznesit).

## DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

### Neni 24

#### Legjislacioni i zbatueshëm

1. Shoqëria do të ushtrrojë aktivitetin e saj në përputhje me Aktin e Themelimit, Statutin dhe legjislacionin shqiptar në fuqi për shoqëritë tregtare.
2. Për sa nuk është shprehur në këtë statut i referohet plotësisht nga Asambleja e Përgjithshme duke mbajtur parasysh kërkesat e ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, si dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.
3. Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis palëve nëse nuk gjejnë zgjidhje me bisedime e mirëkuptim, do të zgjidhen në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor përkatës (*Kompetenca Territoriale*).
4. Çdo ndryshim e plotësim në statut nuk prek personalitetin juridik të shoqërisë tregtare "DUEMARI" sh.p.k.

Për sa më sipër, ne themeluesit hartuam STATUTIN e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "DUEMARI" sh.p.k, bazuar në vullnetin tim të lirë e të plotë, si dhe në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për shoqëritë tregtare.

Pasi e hartova, e lexova dhe kuptova qartazi rëndësinë dhe efektet ligjore të saj, ne ortakët themelues e nënshkruajme statutin e shoqërisë "DUEMARI" sh.p.k. sipas ligjit.

## ORTAKU I VETEM THEMELUES I STATUTIT TË SHOQËRISË MË PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"DUEMARI" SH.P.K.

Zaho Tozaj                      Fabio Likaj

